

L I G J
Nr.9460, datë 21.12.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 30 “Pajisja me certifikatë tatimore”, në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Personat e tatueshëm kanë selinë qendrore në vendin e menaxhimit efektiv të biznesit. Kriteret për përcaktimin e vendit efektiv të biznesit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 2

Në fund të nenit 36 “Metodat alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve këshillohet me shoqatat e specializuara të biznesit, për të përcaktuar vlerën orientuese të tatueshme, në bazë të së cilës bëhet përcaktimi i detyrimeve tatimore. Vlera orientuese e tatueshme përcaktohet me akte nënligjore.”.

Neni 3

Në nenin 53 “Shkeljet dhe dënimet për moslejimin e hyrjes dhe të kontrollit”, pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Në çdo rast, të drejtën e dënimit me gjobë, sipas pikës 1 të këtij neni, e ka kryetari i degës së tatimeve.”.

Neni 4

Në nenin 55 “Procedurat e apelimit”, në fund të pikës 3 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Për qëllime të këtij ligji ose të ligjeve të tjera tatimore, datë e marrjes së njoftimit të vlerësimit apo të njoftimeve të tjera zyrtare, vlerësohet dita e dhjetë pas dorëzimit të njoftimit në shërbimin postar. Përgjegjësia për mosmarrjen në kohë të njoftimit të dorëzuar në shërbimin postar është e tatimpaguesit, i cili është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve nga shërbimi postar.

Administrata tatimore mund ta dërgojë njoftimin e vlerësimit ose njoftimet e tjera zyrtare dorazi. Në këtë rast, datë e marrjes së njoftimit vlerësohet data, kur njoftimi i jepet në dorë tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rast refuzimi nga tatimpaguesi, njoftimi vlerësohet i marrë në datën e refuzimit.”.

Neni 5

Në fund të nenit 56 “Procedurat e shqyrtimit të apeli­meve tatimore” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastin e një apeli­mi tatimor, organi që ka të drejtën e shqyrtimit të apeli­mit ka, gjithashtu, të drejtën të heqë tërësisht apo pjesërisht dënime­, pavarësisht nga fakti nëse detyrimi për tatimin qëndron ose jo.”.

Neni 6

Neni 57 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 57

Për shqyrtimin e apeli­meve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve krijohet Drejtoria e Apeli­meve Tatimore, si pjesë përbërëse e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtori i Drejtorisë së Apeli­meve Tatimore emërohet nga Ministri i Financave. Drejtoria e Apeli­meve Tatimore ka autoritetin e nevojshëm për të shqyrtuar apeli­met që kanë të bëjnë me vlerësimet tatimore, të paraqitura nga tatimpaguesit, përfshirë edhe të drejtën për të kryer hetime, kontrole dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore. Në bazë të shqyrtimit të apeli­meve, ajo merr vendimin përkatës. Drejtoria e Apeli­meve Tatimore është e pavarur në vendimmarrje. Vendimi i kësaj Drejtorie duhet të jetë i argumentuar dhe të merret jo më vonë se 30 ditë nga data, kur është paraqitur kërkesa për apeli­m nga tatimpaguesi. Mosmarrja e vendimit për rezultatin e apeli­mit brenda afatit dhe mosdërgimi i tij tek tatimpaguesi, i jep të drejtën tatimpaguesit për t'u ankuar në shkallën tjetër më të lartë të apeli­mit, pa paraqitur rezultatin e shqyrtimit të shkallës më të ulët të apeli­mit.”.

Neni 7

Pas nenit 72 shtohet neni 72/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 72/1

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për zbatim si për tatimpaguesit dhe për administratën tatimore, edhe për administrimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu